



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

**10.01.2018, Prishtinë,
Ref:01.12.2017\584-2017**

**Opinion i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, në mbledhjen e bordit të mbajtur më 19 dhjetor 2017, shqyrtoi ankesën e Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot lidhur me artikullin "Mafio-oligarkët hedhin milionat e krimin në balotazh", botuar më 31 tetor 2017, dhe nxorri këtë

O P I N I O N

- Ankesa miratohet

A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se Shpend Ahmeti ka bërë pazar me vëllezërit Devolli dhe se grupet e mëdha kriminele siç janë Devollët pritet të shtojnë buxhetin për të përkrahur njerëz të cilët janë vartës të tyre prej të cilëve marrin tender dhe tokë. Në ankesë thuhet se për asnjërën nga këto citate të lartpërmendura, gazeta nuk ka dhënë mbështetje të argumenteve.

KMShK, pasi e shqyrtoi ankesën dhe artikullin e lartpërmendur vendosi se gazeta ka bërë shkelje të Kreut II (Raportimi i së vërtetës), pasi që ka botuar vetëm prononcimet e një grupi të analistëve të saj, pa i mundësuar edhe kompanisë Devolli që të prononcohet ose ndonjë organi kompetent apo ndonjë burimi të pavarur në mënyrë që të krijohej një pasqyrë më e qartë rreth temave që i ka shqyrtuar në artikull. Në këtë mënyrë edhe lexuesi do të përfitonte duke pasur parasysh se do të krijohej një spektër i gjerë i pikëpamjeve dhe fakteve në të mirë të së vërtetës.

Gjithashtu, KMShK konstatoi se gazeta nuk ka botuar asnjë prononcim të palës tjetër për çka ka qenë e obliguar sipas Kodit të Mediave të Shkruara, me çka do të përmbushej obligimi që del nga Kreu IV (E drejta për t'u përgjigjur) i Kodit të Mediave të Shkruara.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij opinionit.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës